



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE TRAJNIMIT

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT

LËNDA: GJUHË ANGLEZE

(klasa e nëntë)

Tiranë, 2008

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

- I. HYRJE**
- II. SYNIMET**
- III. STRUKTURA E PROGRAMIT**
- IV. OBJEKTIVAT E PROGRAMIT**
- V. SHPËRNDARJA E ORËVE**
- VI. INTEGRIMI**
- VII. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT**
- VIII. VLERËSIMI DHE VETËVLERËSIMI**
- IX. SHTOJCA**

I. HYRJE

Programi mësimor i gjuhës angleze për klasën e 9^{të} është hartuar në përputhje me Kurrikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar, me Kuadrin Evropian të Referencave për Gjuhët që t'i përgjigjet një Shoqërie të Hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës angleze në vendin tonë.

Programi i gjuhës angleze për klasën e 9-të paraqet njohuritë gjuhësore, aftësitë e shprehitë komunikuese, si dhe vlerat kulturore përmes të cilave nxënësi përforcon e thellon njohuritë e fituara në klasat e mëparshme duke rritur aftësitë e tij shprehëse në gjuhën angleze. Ai shërben për formimin e përgjithshëm të nxënësit nga ana gjuhësore, social-kulturore dhe intelektuale. Niveli gjuhësor rritet në mënyrë spirale duke përsëritur çfarë është zhvilluar në vitet e mëparshme dhe duke nxënë njohuri të reja në mënyrë të përshkallëzuar. Programi mban parasysh grup-moshën e nxënësve dhe karakteristikat e tyre përkatëse. Në të pëfshihen objektiva, linja dhe nënlinja që jo vetëm lidhen me interesat e tyre moshore, por edhe nxitin interesin dhe zgjojnë kureshtjen për mësimin e gjuhës angleze. Në klasën e nëntë nxënësi është në gjendje të shprehet për veten dhe botën rreth tij ,duke zgjeruar njohuritë mbi kulturën e vendeve anglofone, si dhe njohuritë e përgjithshme. Mësimi i gjuhës, në programin e klasës së nëntë shenon perfundimin e nivelin A2+ dhe kalimin në nivelin B1.

II. SYNIMET

Programi i gjuhës angleze për klasën e nëntë synon që nxënësi:

- ❖ **të thellojë** njohuritë gjuhësore si ato receptive dhe shprehëse përmes të cilave ai zgjeron njohuritë mbi botën dhe formohen intelektualisht;
- ❖ **të ndërjegjësohet** për aspektet kulturore dhe të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendeve anglofolëse dhe kulturës amtare;
- ❖ **të rrisin** aftësinë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata praktike;
- ❖ **të forcojë** ndërveprimin në situata reale lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore ashtu edhe jashtëshkollore;
- ❖ **të konsolidojë** bashkveprimin përmes punës në grup dhe shprehive të një pune të pavarur individuale dhe krijuese.

III. STRUKTURA E PROGRAMIT

Programi i gjuhës angleze për klasën e nëntë ndërtohet mbi bazën e katër aftësive gjuhësore:

1. të dëgjuarit
2. të lexuarit
3. të folurit
4. të shkruarit

Për secilën aftësi përcaktohen objektivat e të nxënësve. Këto aftësi realizohen nëpërmjet linjave dhe nënlinjave të përmbajtjes:

Linja	Nënlinja
1. Komunikimi dhe Formimi Kulturor	1.1 Kultura dhe Komunikimi 1.2 Aktet dhe Funkcionet e Komunikimit
2. Formimi Gjuhësor	2.1 Struktura Gramatikore

Në fund të programit gjenden Shtojcat, në të cilat pasqyrohen shembuj praktikë(jo të detyruar), të zbatimit të programit mësimor.

IV. OBJEKTIVAT E PROGRAMIT

Objektivat e programit të klasës së nëntë përcaktohen në mbështetje të Udhëzimit të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës Nr.49, dt.27.12.2006 “Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve”.

Objektivat detajohen sipas aftësive, linjave dhe nënlinjave. Ato vëzhgohen dhe maten nga mësuesi dhe vetë nxënësi. Përcaktimi i objektivave i jep mundësi nxënësit që të jetë i pavarur gjatë procesit mësimor.

IV.1. Objektivat sipas aftësive gjuhësore

Të dëgjuarit

Në përfundim të klasës së nëntë nxënësi të jetë i aftë:

- ❖ **të ndjekë** një ligjeratë të shqiptuar qartë që i drejtohet atij në një bisedë të përditshme, edhe kur herë here kërkohet përsëritja e disa fjalëve dhe shprehjeve;
- ❖ **të identifikojë** pikat kryesore të një bisede mbi tema të njohura lidhur me shkollën, familjen, kur gjuha është e qartë dhe standarde;
- ❖ **të ndjekë** në vija të përgjithshme pikat kryesore të një diskutimi me kusht që shqiptimi të jetë i qartë;

- ❖ **të dallojë dhe të kuptojë** thelbin e programeve televizive mbi tema të njohura si dhe disa hollësi mbi vendin dhe kohën kur ato shoqërohen me pamje televizive;
- ❖ **të reagojë** ndaj një mesazhi të shkurtër, të thjeshtë e të qartë, si p.sh. spote publicitare, lajmërimet, përmbledhje lajmesh;
- ❖ **të ndjekë** udhëzimet mbi përdorimin e një paisjeje elektroshtëpiake si televizor, video, magnetofon etj.;
- ❖ **të dallojë** pa vështirësi pjesët kryesore të materialeve të thjeshta e të shkurtra, mbi tema të njohura, nëse janë të shqiptuara qartë e ngadalë dhe të regjistruara pastër.

Të lexuarit

Në përfundim të klasës së nëntë nxënësi të jetë i aftë:

- ❖ **të lexojë** për subjektin e një tregimi të strukturuar mirë dhe të dallojë ngjarjet më të rëndësishme, elementët më thelbësorë apo detajet e kërkuara;
- ❖ **të kumtojë** tekste të qarta në lidhje me interesat e tij dhe të nxjerrë herë-herë nga konteksti kuptimin e fjalëve të panjohura;
- ❖ **të gjejë** dhe të kuptojë si informacionin e përgjithshëm ashtu dhe atë të veçantë e të nevojshëm në shkrime të përditshme si: letrat, fletëpalosjet, reklamat në internet etj;
- ❖ **të identifikojë** çështjet më të rëndësishme në artikuj gazetash mbi tema të njohura e të shkruara qartë;
- ❖ **të tregojë** në mënyrë të mjaftueshme kuptimin e ngjarjeve, ndjenjave dhe dëshirave, në letra personale apo të një korespondence;
- ❖ **të lexojë** instruksionet e qarta për përdorimin e një aparati, si: telefon, kompjuter, DVD etj.

Të folurit

Në përfundim të klasës së nëntë nxënësi të jetë i aftë:

- ❖ **të zhvillojë** me lehtësi e pa përgatitje një bisedë të drejtpërdrejtë mbi tema të njohura, si p.sh.:familja, shokët, koha e lirë si dhe të shkëmbejë informacionin e nevojshëm;
- ❖ **të diskutojë** mbi tema të njohura, por herë- herë të hezitojë e të vihet në vështirësi dhe të riformulojë atë që do të shprehë;
- ❖ **të tregojë** përmbajtjen e një libri apo filmi;
- ❖ **të japë** mendime e të përshkruajë përshtypjet e tij;
- ❖ **të përshkruajë** planet, projektet e ambiciet e tij, duke dhënë arsye e shpjegime;
- ❖ **të përshkruajë** me hollësi një ngjarje reale dhe të shprehë përshtypjet për të;
- ❖ **të shprehë** pikëpamjet e tij vetjake mbi zgjidhjet e një problemi dhe të ftojë të tjerët të shprehin mendimin apo të sqarojnë qëndrimin e tyre;

- ❖ **të përballojë** situatat që i paraqiten gjatë një udhëtimi duke shfrytëzuar me shkathtësi aftësitë gjuhësore të fituara;
- ❖ **të shprehë** me mirësjellje bindjet e tij, opinionet, nëse është dakort apo jo.
- ❖ **të kërkojë** e të transmetojë një informacion të thjeshtë ose të drejtpërdrejtë, duke kërkuar dhe ndjekur udhëzimet përkatëse;
- ❖ **të zotërojë** një fjalor të mjaftueshëm për t'u shprehur me ndihmën e perifrazave mbi tema të përditshme, si: shkolla, udhëtimet etj, me një shqiptim të mirë, pavarësisht gabimeve rastësore apo theksit jo të përshtatshëm;
- ❖ **Të bëjë ftesa**, të kërkojë të falur dhe t'u përgjigjen atyre me mirësjellje.
- ❖ **të shprehet** kuptueshëm dhe me zhdërvjelltësi, pavarësisht nga pauzat për të gjetur fjalën e duhur apo korrigjuar, kur ka sekuenca të gjata e të krijuara lirshëm;
- ❖ **të transmetojë** një informacion të thjeshtë me interes imediat, duke vënë në dukje çështjet më të rëndësishme dhe të shprehë thelbësoren në mënyrë të kuptueshme.

Të shkruarit

Në përfundim të klasës së nëntë nxënësi të jetë i aftë:

- ❖ **të shkruajë** tekste të strukturuar mirë mbi tema të interesit vetjak;
- ❖ **të përshkruajë** një ngjarje reale apo imagjinare, me fjalor të përshtatshëm për shkrimet narrative e të kronikës;
- ❖ **të kërkojë** me shkrim informacionin e duhur për interesat e tij, si p.sh.: kurse për mësimin e gjuhës dhetë shprehë kërkesat e tij specifike për këtë shërbim;
- ❖ **të përshkruajë** thjeshtë e saktë përmbajtjen e një libri apo filmi, duke dhënë kërkesat e tij specifike për këtë shërbim;
- ❖ **të shkruajë** letra rreth përvojave personale dhe të shprehë ndjenjat, si: gëzim, trishtim, habi, keqardhje etj;
- ❖ **të përshkruajë** dëshirat, ëndrrat, ambiciet dhe planet për të ardhmen;
- ❖ **të shkruajë** raporte të shkurtra që informojnë dhe justifikojnë një veprim.

IV. 2 Objektivat sipas linjave dhe nënlinjave

LINJA 1: Komunikimi dhe Formimi Kulturor

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë zhvillon më tej bazat e gjuhës që janë të domosdoshme për një komunikim me një standard më të lartë gjuhësorë, të cilat janë dhënë në klasat e mëparshme. Nëpërmjet situatave të ndryshme, tërheqëse për moshën, kjo linjë ndihmon zhvillimin e gjithanshëm të nxënësit në aspektin njohës, gjuhësor, emocional dhe kulturor. Ajo zhvillon aftësitë e përgjithshme gjuhësore në përputhje me grup-moshën e nxënësve.

Nënlinja 1.1: Kultura dhe Komunikimi

Përshkrimi i nënlinjës. Në këtë nënlinjë përshkruhen aspekte të jetës së përditshme, ku realizohen objektivat e aftësive të të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit. Nxënësi aftësohe të:

- të ndjekë biseda
- të hamendësojë,
- të kuptojë thelbin
- të kuptojë detaje
- të sqarojë,
- të këmbejë,
- të miratonë
- të percjellë informacion
- të shprehë pikëpamjet
- të diskutojë
- të ebatojë
- të tregojë,
- të përsërisë,
- të ndërveprojë,
- të shkruajë,
- të hartojë,
- të përshkruajë

situata të ndryshme, si p.sh. jeta e përditshme, jeta në shkollë, bota përreth nesh, bota e komunikimit, jeta personale dhe shoqërore etj.

Nënlinja 1.2: Aktet dhe Funksonet e Komunikimit

Përshkrimi i nënlinjës: Kjo nënlinjë njeh nxënësit me rëndësinë e komunikimit, funksionet e tij si dhe instrumentet, mjetet, mediat dhe sjelljet e komunikimit.

Nxënësi aftësohet:

- të miratojë,
- të kundërshtojë,
- të kërkojë dhe japë leje,
- të urojë,
- të bëjë hipoteza,
- të shprehë keqardhje dhe dëshira,
- të falë dhe të kërkojë falje,
- të inkurajojë,
- të shprehë preferenca,
- të këshillojë,
- të kërkojë dhe të ofrojë,
- të kërkojë informacion,
- të sugjerojë,
- të arsyetojë,
- të kërkojë përsëritje,

- të përshkruajë eksperiencën,
- të ankojë,
- të vendosë kushte,
- të pyesë për sqarime,
- të planifikojë,
- të përshkruajë eksperiencën

në situata të jetës së përditshme, si: festa, takime, ditëlindje, treg, vende të panjohura, shkollë, mbrëmje, eskursione etj.

LINJA 2: Formimi Gjuhësor

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë aftëson nxënësin të prodhojë elemente të thjeshta të gjuhës angleze. Nëpërmjet situatave të ndryshme praktike, nxënësi nxitet të mësojë strukturat elementare gramatikore të gjuhës angleze dhe t'i përdorë saktë ato.

Nënlinja 2.1: Struktura Gramatikore

Përshkrimi i nënlinjës: Kjo nënlinjë përqendrohet në konsolidimin dhe përdorimin e strukturave të thjeshta gramatikore

Nxënësi aftësohet:

- të dallojë;
- të shkruajë;
- të tregojë;
- të riprodhojë;
- të përdorë,
- të analizojë

të gjitha çështjet gramatikore që janë trajtuar në klasat e mëparshme, por në klasën e nëntë ato trajtohen në mënyrë më të plotë duke u bërë një analizë gramatikore (morfologjike dhe sintaksore) dhe semantike që materializohen në situata të ndryshme nga jeta e përditshme, si p.sh.: foljen në kohën e tashme dhe të shkuar, foljen në kohën e kryer dhe në të kryerën e plotë, të pakryerën, formën veprorë dhe pësorë, ligjëratën e drejtë, kushtoren, kohoren, format me –ing të foljeve, lidhëzat, folje frazale, foljet modale, përemrat vetorë, dëftorë, pyetës dhe pronorë, rendin e fjalëve në fjali, mbiemrat e format e tyre, ndajfoljet, nyjet nëpërmjet situatave të ndryshme nga jeta e përditshme.

V. SHPËRNDARJA E ORËVE

35 javë x 3 orë = 105 orë vjetore

Nr.	Linjat	Sasia e orëve
1	Komunikimi dhe formimi kulturor	57
2	Formimi gjuhësor	38
	Orët e lira	10

Shpërndarja e orëve, e planifikuar sipas linjave, qartëson raportet sasiore ndërmjet linjave.

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në kapituj e njësi mësimore) objektivat e secilës linjë mund të ndërthuren me njëra-tjetrën dhe mund të zënë vend aty ku përdoruesi e sheh më të arsyeshme për t'i zbatuar. Konceptimi i kapitujve të tekstit dhe njësive mësimore është e drejtë dhe detyrë e autorit të tekstit dhe mësuesit. E rëndësishme është në këtë rast, që zbatuesit e programit të jenë të vëmendshëm në realizimin cilësor të të gjitha objektiveve të përcaktuara në këtë program, duke u qartësuar se objektivat e linjave dhe nënlinjave nuk janë shënuar sipas rendit të përparësive. Ato duhet të interpretohen si kërkesa që duhen realizuar në mënyrë të mjaftueshme për të siguruar arritjen e tyre nga nxënësit.

Orët e planifikuara për secilën linjë përmbajtjeje shërbejnë për realizimin e objektiveve të programit nga autorët për shtjellim të mësimëve, aktiviteteve gjuhësore dhe orëve të përsëritjes

Komunikimi dhe formimi kulturor zë 57 orë. Pa rënë ndesh me parimin e autonomisë së mësuesit në mësimdhënie, 57 orë mësimore i kushtohen veprimtarive me karakter komunikimi. Mësuesi përdor materiale të ndryshme didaktike si: teksti, revista, materiale integruese etj. Gjatë procesit mësimor rimerren, përsëriten dhe përforcohen njohuritë e fituara.

Formimi gjuhësor zë 38 orë. Janë kryesisht orë në të cilat mësuesi shtjellon në bashkëveprim me nxënësit njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore (gramatikore e leksikore). Rimerren dhe përforcohen njohuritë e mësuara më parë, si edhe ato të reja.

Qëllimi *i orëve të lira* (rreth 10% e orëve totale), është që t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësit në përputhje me kërkesat e programit zyrtar, të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për lëndën e Gjuhës Angleze dhe Udhëzimin Nr. 38, dt. 9.10.2007 i MASH për orët e lira.

Organizimi i lojërave gjuhësore me elementë që zhvillojnë të menduarit logjik dhe kritik në shërbim të një objektivi të paracaktuar; organizimi i konkurseve brenda klasës edhe për një kapitull; lojëra të ndryshme zbavitëse; përforcimi i njohurive i shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxënit, ashtu edhe mësimdhënien janë disa veprimtari rekomanduese për rubrikën e orëve të lira.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve të lira mund të bashkëpunohet edhe me mësuesi/et e lëndëve të tjera, duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët (në formën e një projekti ose të një teme komplekse), që shfrytëzon lidhjet konceptuale të gjuhës angleze me lëndët e tjera dhe aspektet ndërkurrikulare.

Shpërndarja dhe shumëllojshmëria e aktiviteteve në vendin e duhur përgjatë procesit mësimor akademik është një element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të rubrikës së orëve të lira.

Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar kryesisht për qëllime rutinë, të cilat nuk ndihmojnë në arritjen e objektivave të këtij programi.

VI. INTEGRIMI

Programi i gjuhës angleze për klasën e nëntë mbështetet në integrimin ndërlëndor, duke e shfrytëzuar atë për aftësimin në rritje të nxënësit në përdorimin e njohurive gjuhësore në përgjithësi dhe të katër aftësive (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit e të shkruarit).

Konceptet e njohuritë gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore, të cilat lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës angleze dhe të trajtuara në lëndët e tjera.

1. Kjo ndërthurje mes *shkencave natyrore* p.sh. matematikës dhe gjuhës së huaj shprehet në mësimin e shifrave, numrave, veprimeve matematikore: mbledhja e zbritja etj.
2. Në lëndën e *biologjisë*, lidhja reflektohet tek linja “Komunikimi dhe Formimi Kulturor” kryesisht tek tematika “Bota rreth nesh”, duke trajtuar tema si: ushqyerja, shëndeti. etj
3. Me **artet** janë të lidhura ngushtë temat mbi sportin, muzikën, modën, pikturën si pjesë e fushës tematike “Jeta e përditshme”. etj
4. Me **shkencat sociale** janë të lidhura tema si: miqësia, marrëdhëniet familjare, festat etj., pjesë këto të fushës tematike “Jeta personale e shoqërore”

Trajtimi ndërlëndor u shërben synimeve të përgjithshme të programit si dhe realizimit të objektivave të linjave dhe nënlinjave të tij, kryesisht për:

A. Edukimin intelektual:

Përmes ndërthurjes së njohurive të ndryshme nxënësi arrin të zbulojë, analizojë, sintetizojë dhe vlerësojë, duke rritur cilësinë e nxënies.

B. Edukimin qytetar

Edukimi mjedisor. Ndotja, mbrojtja e ambientit janë tema që shoqërohen me fjalor e struktura gjuhësore, të cilat trajtohen jo si një qëllim më vete, por në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ.

Edukimi kulturor dhe etik. Përmes lëndëve histori dhe gjeografi, nxënësi fiton njohuri mbi vendet anglishtfolëse. Këto njohuri ndërthuren me dijet mbi kulturën e këtyre vendeve, zakonet e doket e tyre, mënyrën e jetesës etj. Këtu nuk mund të lihen pa përmendur edhe shprehitë etike të këtyre popujve. Nxënësi mëson të ndërveprojë në situata të ndryshme me sjellje etike të përshtatshme, të cilat trajtohen përmes funksioneve gjuhësore, si: të kërkojë falje, të pyesë etj.

Edukimi për të drejtat e njeriu. Njohja e kulturave të vendeve anglishtfolëse trajtohet ngusht me temat e barazisë sociale, diskriminimit social, respektit reciprok etj.

Atdhedorshuria. Duke njohur kulturat e popujve të vendeve anglishtfolëse nxënësi bën krahasime me kulturën amtare dhe ndërgegjegjësohet për identitetin e tij kombëtar.

VII. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Realizimi i objektivave të mësipërm mbështetet në:

- ***Krijimin e një mjedisi real të të mësuarit të gjuhës angleze.***

Respektimi i aftësive moshore, psiqike, fizike dhe intelektuale të nxënësit është një domosdoshmëri për të siguruar suksesin e punës me këtë grup-moshë.

Nxënësit e kësaj grup-moshe mësojnë më mirë në mjedise reale. Mësuesi/ja, në varësi të temës që trajton, krijon ndjenjën dhe atmosferën e lojës; lejon që nxënësi të bashkëbisedojë, të recitojë vjersha të shkurtra, të këndojë, të thotë edhe ndonjë fjalë pa kuptim. Pra, në këtë mënyrë lodrat, këngët, vjershat, tregimet dhe veprimtaritë fizike karakterizojnë të gjithë procesin mësimor. Këto veprimtari konceptohen në mënyrë të thjeshtë që nxënësi të kuptojë atë që i kërkohet.

- ***Shumëllojshmërinë e veprimtarive.***

Në çdo orë mësimi, mësuesi/ja nxit imagjinatën dhe mendimin krijues të nxënësit duke i krijuar atij mundësi të marrë pjesë aktive në procesin mësimor.

Detyrat e dhëna janë në përputhje me nivelin e kësaj grup-moshe dhe si të tilla janë të realizueshme dhe nxitëse. Për këtë arsye mësuesi/ja përdor teknika të ndryshme dhe mjete didaktike të përshtatshme.

- ***Rëndësinë e të dëgjuarit.***

Dëgjimi është një aftësi e rëndësishme gjuhësore. Mësuesi/ja mundëson zhvillimin e kësaj aftësie nëpërmjet veprimtarive të tilla, si p.sh., situata autentike të dëgjuara në kasete, CD, DVD, si edhe tregime të bazuara në piktura, fotografi ose në mjete të tjera nxitëse vizuale.

- ***Njohjen me gramatikën.***

Karakteristikë e kësaj moshe është përvetësimi i gramatikës nëpërmjet lojërave gjuhësore. Mësuesi/ja nuk synon t'i mësojë nxënësit rregullat gramatikore, por e ndërgegjegjëson atë duke i dhënë modele gjuhësore sa më afër komunikimit real. Qortimet gramatikore bëhen me ushtrime gojore, të cilat praktikojnë forma, tëndryshme duke theksuar mësimin e modelit dhe jo shpjegim të mirëfilltë gramatikor.

- ***Trajtimin e të shkruarit.***

Mësuesi/ja ndërton veprimtari për zhvillimin e kësaj aftësie me shumë kujdes dhe në kohën e duhur. Një pjesë të tyre e përdor për aftësimin e nxënësve në drejtshkrimin e fjalëve dhe pjesën tjetër për shprehjen e mendimeve nëpërmjet të shkruarit si aftësi

gjuhësore. Kjo trajtohet me shumë kujdes dhe në kohën e duhur, pasi lidhet me nivelin e njohjes së alfabetit dhe tipat e veprimtarive të të shkruarit. Gjithmonë të mbahet parasysh që nxënësi ende nuk ka përsosur mjaft elemente të të shkruarit në gjuhën amtare.

- **Trajtimi i gabimeve.**

Në këtë grup-moshë është normale të bëhen gabime gjatë mësimit të gjuhës angleze. Mësuesi/ja bën kujdes në qortimin e gabimeve duke mos frenuar iniciativën dhe shprehjen e lirë të nxënësve dhe duke mos e penalizuar nxënësin për gabimet që bën.

VIII. VLERËSIMI DHE VETËVLERËSIMI

Mësuesi/ja duke u mbështetur te standardet e dhëna në program, përcakton standarde të pritshme për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga ndryshimet e tyre individuale, gjuhësore, emotive dhe kulturore.

Për këtë grup-moshë rëndësi ka vlerësimi pozitiv i tyre. Asgjë nuk është më nxitëse sesa suksesi i arritur.

Mësuesi/ja monitoron dhe qorton detyrat duke përcaktuar objektiva të qartë.

Mësuesi/ja, nëpërmjet vlerësimit, “zbulon” shkallën e përfitimit e të konsolidimit (nga ana e nxënësit) të njohurive, aftësive dhe shprehive të përfshira në këtë program. .

Vlerësimi organizohet në disa forma:

1. Vlerësim i vazhdueshëm me gojë.
2. Vlerësim me shkrim

Ky vlerësim bëhet në mbështetje të realizimit të objektivave të linjave dhe nënlinjave.

Vlerësimi me shkrim dhe me gojë klasifikohet në:

- ❖ Vlerësim formues, me anë të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënësi/ja në formimin e tij/saj gjuhësor në përputhje me objektivat e caktuara.
- ❖ Vlerësim diagnostikues, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe përvetësimin e materialit gjuhësor të dhënë më parë. Ai, gjithashtu, jep informacion për efektshmërinë e të nxënësve dhe ndihmon në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies/nxënies.
- ❖ Vlerësim i planifikuar mbi bazën e realizimit të objektivave të nënlinjave, pra në bazë kapitulli. Ky vlerësim bëhet me notë dhe realizohet në fund të çdo mësimi përsëritës.
- ❖ Vlerësim motivues, i cili ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënësit për mësimin e gjuhës angleze. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor.

Vlerësimi përfundimtar është vlerësimi me notë që finalizon arritjet e objektivave të linjave dhe nënlinjave për këtë grup-moshë.

Vetëvlerësimi është element i rëndësishëm në mësimin e gjuhës angleze për këtë grup-moshë. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e tyre në vazhdimësi. Gjatë vetëvlerësimit në procesin mësimor ndiqen këta hapa:

Mësuesi/ja diskuton me nxënësit atë që ata do të arrijnë në klasë;

Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas mësuesi/ja dhe nxënësit bëjnë komentën përfundimtar;

Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit/es;

- ❖ Nxënësi mban shënim arritjet e tij duke përdorur edhe gjuhën amtare;
- ❖ Mësuesi/ja bisedon me nxënësin individualisht dhe i tregon arritjet.

Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Njohja e nxënësit me vetëvlerësimin e ndërgjegjëson atë të kuptojë më mirë problemet e të mësuarit.